

L I G J
Nr.8164, datë 21.11.1996

**PËR SIGURIMIN E TRANSPARENCËS NË VEPRIMTARINË E HUAMARRJES ME
PJESËMARRJE MASIVE TË INDIVIDËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Subjektet që ushtrojnë veprimtari të huamarrjes me pjesëmarrjen masive të individëve në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të republikës së Shqipërisë, duhet të marrin masa që të sigurojnë transparencë lidhur me këtë veprimtari.

Neni 2

Për mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie krijohet një komision mbikëqyrës jashtëparlamentar i përbërë nga personel akademik dhe specialistë të fushave të drejtësisë, makroekonomisë e financave, që nuk kanë asnjë lloj interesi në lidhje me këtë veprimtari.

Komisioni mbikëqyrës përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët miratohen nga Kuvendi Popullor, me propozimin e komisionit për ekonominë, buxhetin, financat e privatizimin.

Neni 3

Komisioni mbikëqyrës vepron si një organizëm i pavarur, i cili ka të drejtë që, brenda kuadrit të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera, të kontrollojë shtrirjen e përmasat dhe aspekte të tjera që sigurojnë transparencën e nevojshme të kësaj veprimtarie, me qëllim që të sigurohet transparenca e nevojshme lidhur me të.

Komisioni mbikëqyrës nuk ndikon dhe nuk mban përgjegjësi për kushtet në të cilat zhvillohet kjo veprimtari, e cila kryhet tërësisht në përputhje me vullnetin e subjekteve palë të saj dhe nën përgjegjësinë e plotë juridike civile të tyre në lidhje me këto kushte dhe pasojat e ardhura prej tyre.

Për veprimtarinë e tij dhe përfundimet e arritura, komisioni i raporton periodikisht komisionit të Kuvendit Popullor për Ekonominë, Buxhetin, Financat e Privatizimin.

Neni 4

Komisioni mbikëqyrës ka për detyrë:

1 Të mbledhë informacione lidhur me shtrirjen dhe përmasat e kësaj veprimtarie.

2 Të ndjekë zbatimin e legjislacionit civil të republikës së Shqipërisë nga ana e subjekteve pjesëmarrëse, në lidhje me veprimtarinë e huamarrjes të ushtruar prej tyre.

3 Të mbikëqyrë respektimin e të drejtave dhe interesave pasurore të pjesëmarrësve në këtë veprimtari.

4 Të studiojë efektet e saj në ekonominë e vendit, si dhe përvojën e vendeve të tjera, në të cilat ajo ka qenë e përhapur.

5 Mbi bazën e këtyre informacioneve dhe studimeve, të hartojë rekomandime për komisionin e Kuvendit Popullor për ekonominë, buxhetin, financat e privatizimin.

Neni 5

Subjektet që ushtrojnë këtë lloj veprimtarie kanë për detyrë t'i paraqesin komisionit mbikëqyrës, sipas kërkesës, informacionet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me të .

Komisioni mbikëqyrës është i detyruar që të ruajë karakterin konfidencial në lidhje me të gjitha të dhënat e përfituara në këtë formë, me përjashtim të të dhënave që janë përfitur nga burime publike të informacionit, ose që janë bërë të njohura njëkohësisht edhe prej këtyre të fundit.

Detyrimi për ruajtjen e karakterit konfidencial të këtyre të dhënave shtrihet edhe për komisionin e Kuvendit Popullor për ekonominë, buxhetin, financat e privatizimin. Ky i fundit mund të bëjë publike të dhënat e marra nga komisioni mbikëqyrës, duke i paraqitur ato në një formë të tillë që të mos lejojnë nxjerrjen e përfundimeve për subjektet specifike, të cilëve i referohen ato.

Neni 6

Komisioni mbikëqyrës ka të drejtë të angazhojë në veprimtarinë e tij edhe specialistë të fushave të ndryshme, të cilët duhet të plotësojnë kushtet për konfliktin e interesave dhe për ruajtjen e karakterit konfidencial të të dhënave. Detyrimi për ruajtjen e sekretit të të dhënave zbatohet prej tyre edhe pas marrjes fund të angazhimit të tyre për llogari të komisionit mbikëqyrës.

Neni 7

Për ushtrimin e veprimtarisë së tij, komisioni mbikëqyrës harton një rregullore të brendshme në përputhje me këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtre të Republikës së Shqipërisë.

**Shpallur me dekretin nr.1657, datë 4.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**